VENDIM
Nr.593, datë 9.9.1996

PËR ZBATIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHBA-SË PËR ZGJIDHJEN E DISA PRETENDIMEVE", RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.7913, DATË 6.4.1995

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në zbatim të "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së SHBA–së për zgjidhjen e disa pretendimeve", ratifikuar me ligjin nr.7913, datë 6.4.1995, t'i kthehen Shoqërisë së Misionit Babtist Konservativ pronat në qytetin e Korçës si vijon:

a) Shkolla amerikane që ndodhet në rrugën "Dh.Cickes" (sot rruga"Niko Dodona), e njohur si shkolla amerikane, shkolla "Kennedy" ose misioni "Evangjelist";

b) Rezidenca dykatëshe e përdorur më parë për banim nga familjet e personelit pas ndërtesës kryesore të shkollës amerikane;

c) Një pronë prej 27 akrash, e njohur si "Kodra Kennedy" në kodrën e "Shën Athanasit" me pamje nga qyteti i Korçës.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet këshilli i rrethit të Korçës dhe bashkia e Korçës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi